

✓ Nr.DSHT/SOBN 6319 prot.

Tiranë, më 21 10.2020

Drejtuar: Z. Skerdi Drenova
Administrator i OST sh.a

Lënda: Relacion lidhur me ecurinë e zbatimit të fazës Dry Run për implementimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

I nderuar Z. Drenova,

Referuar vendimit të ERE, Nr.106, datë 02.07.2020 mbi miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” dhe fillimin e fazës Dry Run pa efekte financiare si dhe bazuar në Timeline-in e projektit të implementimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike në fazën e Dry Run ecuria e deritanishme lidhur me këtë projekt është si në vijim.

Aktualisht ka përfunduar me sukses Procesi i Parakualifikimit si OSHB për 4 subjekte, ndërkohë që është shfaqur interes edhe nga subjekte të tjera për të marrë statusin e OSHB. Këto kërkesa i janë paraqitur Sektorit përgjegjës për Procedurën e Parakualifikimit dhe po ndiqen në vijim prej tyre.

Ka përfunduar me sukses regjistrimi i Pjesëmarrësve aktual në Tregun Balancues konform dispozitave të Rregullave të TShB. Aktualisht janë të regjistruar në tregun balancues për fazën e Dry Run 4 subjekte si OSHB dhe 23 subjekte si PPB nga të cilat 18 janë PPB me njohje të plotë dhe 5 janë PPB me njohje tregtare. Po vijon puna për metodën e llogaritjes së garancisë financiare për secilin subjekt.

Paralelisht me procesin e regjistrimit të pjesëmarrësve në tregun balancues është krijuar edhe database me të dhënat e Pjesëmarrësve në Tregun Balancues, duke krijuar kështu Regjistrin e PPB-ve dhe Regjistrin e OSHB-ve. Po vijon puna për hedhjen e të gjitha të dhënave për secilin pjesëmarrës të regjistruar.

Gjithashtu ka përfunduar krijimi i një menuje në faqen zyrtare të OST sh.a, e cila përmban publikimet bazuar në dispozitat e Rregullave të TSHB gjatë procesit të Dry Run. Në këtë menu janë publikuar të dhëna dhe informacione mbi Procesin e Dry Run, Rregullat e TShB, Procedurën e Regjistrimit në Treg bashkë me formularët respektiv, Regjistri i PPB-ve dhe Regjistri i OSHB-ve. Në vijim do të publikohen Testimet dhe Rezultatet e tyre si dhe Njoftime të tjera lidhur me këtë fazë.

Paralelisht me të gjithë procesin e kryer janë identifikuar çështjet që do të rishikohen në vijim në rregullat e tregut balancues para hyrjes në operim të tregut lidhur me procedurën dhe formularët e regjistrimit. Hap pas hapi do të identifikohen edhe çështjet e tjera për rishikim.

Në vijim do të ndiqet procesi i përgatitjes së upgrade-t të platformës DAMAS në mjedisin test për testimet e mëvonshme. Paralelisht do të punohet mbi skenarët bazë të tregut lidhur me prokurimin dhe mekanizmin e prokurimit të energjisë balancuese.

Bashkëgjitur gjeni listën e pjesëmarrësve të regjistruar si PPB dhe listën e pjesëmarrësve të regjistruar si OSHB.

Me respekt,

Griselda Merkaj

Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Tregut



Kodi Dry Run	Kompania	Njohja si PPB
DRP/01	Danske commodities Albania sh.a	Tregtare
DRP/02	Energy Ashta	E plotë
DRP/03	Albanian Energy Supplier	E plotë
DRP/04	Devoll Hydropower sh.a	E plotë
DRP/05	GEN-I Tirana shpk	E plotë
DRP/06	GSA shpk	E plotë
DRP/07	Kurum International sh.a	E plotë
DRP/08	Ayen Energy Trading sh.a	E plotë
DRP/09	AXPO Albania sh.a	Tregtare
DRP/10	KESH sh.a	E plotë
DRP/11	Ayen As Energji sh.a	E plotë
DRP/12	NOA Energy Trading shpk	Tregtare
DRP/13	Energija D.O.O Veternik	E plotë
DRP/14	Energy Financing Team Tirana shpk	E plotë
DRP/15	Grid Energy shpk	E plotë
DRP/16	Green Energy Trading Albania shpk	Tregtare
DRP/17	Energy Supply-AL shpk	E plotë
DRP/18	ReENERGY Trading Group shpk	E plotë
DRP/19	ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA	E plotë
DRP/20	POWER AND GAS OPERATIONS (PGO) shpk	Tregtare
DRP/21	FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË sh.a	E plotë
DRP/22	EZ-5 Energy shpk	E plotë
DRP/23	ENER TRADE	E plotë

Kodi Dry Run

Kompania

DRO/01

Devoll Hydropower sh.a

DRO/02

Kurum International sh.a

DRO/03

KESH sh.a

DRO/04

Ayen As Energji sh.a